



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN), më datë **05.03.2014**, realizoi vizitë për ri-kontroll në **Spitalin Psikiatrik Negorci** i shoqëruar nga bashkëpunëtorë të jashtëm të Shoqatës së Psikiatërve, si dhe Shoqatës së Forensikëve të Institutit Mjekësisë Ligjore, në bazë të Memorandumeve për bashkëpunim të nënshkruar paraprakisht.

Qëllimi i vizitës për ri-kontroll është vlerësimi për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i veçantë i MPN nga viti 2012, si dhe identifikimi i rreziqeve shtesë me qëllim të parandalimit të torturës ose llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Vizita në Spitalin Psikiatrik Negorci u realizua në disa hapa. Ekipi i MPN zhvilloi bisedë me personat kompetentë të spitalit ndërsa më pas, me ndarjen në dy nën-ekipe, bëri këqyrje në të gjitha repartet, si dhe në objektet ndihmëse (kuzhinë, trapezari, depon për produkte ushqimore dhe ambulancë). Gjatë vizitës u bë edhe këqyrja e dosjeve mjekësore të reparteve të vizituara, si dhe dokumentacionit për fiksim.

MPN-ja realizoi vizitë targetuese, e cila u fokusua në disa konstatime negative nga raporti i veçantë i vitit 2012, dhe kontroll mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna për përmirësimin dhe eliminimin e mangësive dhe rreziqeve të cilat do të mund të çojnë deri në torturë ose trajtim tjetër brutal, johuman, nënçmues ose ndëshkues.

Në mënyrë plotësuese u vërejtën edhe gjendje të reja, për të cilat kërkohet ndërmarrje e masave përkatëse të cilat, përveç rekomandimeve të vitit 2012, janë dërguar si rekomandime të reja nga vizita për ri-kontroll.

Janë bërë përpjekje dhe janë përmirësuar kushtet në Repartin Kronik B dhe në Repartin Gjqësor. Në repartin kronik kishte krevate për çdo person të vendosur, por megjithatë vërehej shtroja e pistë dhe tualetët e papastër. Në Repartin Gjqësor u vërejtën dyshekë të ri, personave u ishin siguruar dollapë të veçantë. Spitali ka vetëm një pastruese e cila e ka për detyrë të kujdeset për mirëmbajtjen e të gjitha reparteve. Ndërtesat, në të cilat gjendet Reparti Gjqësor dhe Reparti Kronik B janë të vjetra dhe të njëjtat duhet të rinovohen. Drejtoria e spitalit ka siguruar konstruksion financiar për rinovimin e këtyre dy reparteve. Njëherësh, personat e gjinisë femërore, të cilave gjykata u ka shqiptuar masën e sigurisë, janë vendosur nëpër reparte të tjera. Është evident problemi i sigurisë së Repartit Gjqësor, dhe nevoja për angazhimin e institucioneve të tjera kompetente, përkatësisht të Ministrisë së Drejtësisë. Repartet për Psikogjeriatri – reparti i meshkujve dhe reparti i femrave kanë higjienë më të vogël, ndërsa gjendja e ambienteve nuk është në nivelin e nevojshëm. Nevojitet rinovimi i nyjave sanitare dhe i dhomave në të cilat qëndrojnë pacientët më të moshuar. Në Repartin për Psikogjeriatri janë vendosur ndaras pacientët me sëmundje të

rënda të cilët janë të palëvizshëm. Për shkak të gjendjes, në të cilën gjenden këta pacientë, nevojitet furnizim më i shpeshtë i krevateve dhe dyshekëve të rinj, shtroje dhe dollapë tualeti.

Nga Reparti për terapi pune u prezantuan planet e punës, si dhe dokumentacioni përkatës për çdo pacientë veç e veç. Është evident angazhimi për mbështetjen e pacientëve, me ç'rast reparti për terapi pune zhvillon aktivitete në çdo repart. Personeli nënvizoi se pacientët kanë interesim më të madh për aktivitete sportive, ndërsa në mënyrë shtesë, drejtorja e spitalit informoi se planifikohet ndërtimi i një palestere, si dhe një fushë hendbolli dhe basketbolli. Një pjesë e pacientëve të Repartit Gjyqësor janë të angazhuar në sektorin e bujqësisë. Gjithmonë është me rëndësi që personat të motivohen dhe të përfshihen sa më tepër në terapinë e punës e cila do të ndihmojë në procesin e mjekimit.

Edhe gjatë vizitës për ri-kontroll u konstatua se mbahet llogari për dinjitetin dhe integritetin njerëzor të pacientëve, kështu që të njëjtit nuk mbajnë pizhame por përdorin veshmbathjen e tyre.

Gjatë kohës së vizitës së MPN-së nuk kishte pacientë të fiksuar, megjithatë u tha se fiksimi i pacientëve ndodhë shumë rrallë. Për fiksime paraprake, protokollet ishin plotësuar me rregull, ndërsa sipas këqyrjes së dokumentacionit fiksime fizik ka qenë me kohëzgjatje të shkurtër, më së shumti disa orë, tek pacientë të shqetësuar. Nuk ekziston listë e posaçme për dekompensim akut psikik, në listën e imobilizimit fizik është shënuar shkak për të njëjtin, dhe cila terapi dhe medikamente i janë përshkruar. Sipas deklaratave të personelit, pacientët të cilët fizikisht janë imobilizuar janë nën observim të përhershëm të personelit.

Në të gjitha historitë e kontrolluara, u këqyrën historitë paraprake të sëmundjes së pacientëve të Spitalit Psikiatrik Negorci. Në repartet kronike u konstatua se historitë e sëmundjes udhëhiqen me rregull, ndërsa në kartonët shëndetësorë u vërejtën edhe fletë-lëshime nga mjekimet paraprake në institucionin e njëjtë ose në institucion tjetër shëndetësor, përkatësisht mund të ndiqet kronologjia e sëmundjes. Në të gjitha kartonët e kontrolluar shëndetësorë gjendet edhe formulari për dhënien e pëlqimit, ndërsa për çdo ditë kryhen vizita mjekësore për të cilat udhëhiqet edhe fletorja e terapisë, për llojin dhe mënyrën e marrjes së terapisë, për çdo pacientë të shtrirë në spital.

Mekanizmi Parandalues Nacional hartoi raport të veçantë për realizimin e vizitën e realizuar, në të cilin përcaktohet niveli i implementimit të rekomandimeve, u konstatuan gjendje të reja dhe u dhanë rekomandime përkatëse për Ministrinë e Shëndetësisë dhe për Spitalin Psikiatrik Negorci.